


REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
QENDRA E TRANSFERIMIT TE
TEKNOLOGJIVE BUJQESORE
Fushe - Kruje



HC 217 Prot.

DP 04.08

RREGULLORE PER KUSHTET E MAGAZINIMIT, RUAJTJES
DHE SHPERNDARJES TE PLEHRAVE KIMIKE

Miratohet

DREJTORI

Adrian DOKO



Subjektet prodhuese, shperndarese dhe tregtuese, ne cdo kohe dhe per cdo kontigjent plehrash kimike, marrin masa per mbrojtjen e tyre nga kushtet qe shkaktojne tjetersimin e tyre. Kur ruhen keq ato humbasin jo vetem cilesite fizike por edhe ato ushqyese. Ne keto kushte ato krijojne veshtiresi ne shperndarje dhe u ofrojne bimeve me pak elemente ushqyese.

Plehrat kimike te te gjitha llojeve nuk lejohen te mbahen ne ambientin e jashtem, hangare te hapura apo kasolle.

Per ruajtjen e plehrave kimike duhet te ngrihen magazine te posacme. Magazinat ngrihen ne vende qe nuk mbajne uje apo qe kane afer ujerat nentokesore. DysHEMEJA shirohet me zhavorr me trashesi 30-40cm dhe mbi te hidhet betoni ose derrase. Per te penguar ngritjen e kapilareve te ujrave nentoksore, muret e magazines ose te ambientit ku ruhen plehrat, duhet te lyhen ne lartesi deri 1 m me bitum. Ne kete menyre permiresohen kushtet e ruajtjes dhe fenomeni i ngutesimit dhe lengezimit te plehrave kimike te cilet jane shume higroskopik.

Per te ndare plehrat kimike nga njeri tjetri, ne rastet kur nuk ka magazina te vecanta duhet te perdoren perde prej derrase te levizshme. Nga siper, plehrat ne te gjitha rastet, duhet te mbulohen me polietilen ose plasmas me qellim qe te paksohet thithja e lageshtires se tepert e ajrit. Dritaret duhet

te mbahen te mbyllura dhe te hapen per ajrosje vetem ne ditet e kthjellta e me diell.

Plehrat qe jane te ambalazhuar ne thase nuk duhet te vihen drejtperdrejt ne dysHEME edhe ne rastet kur ajo eshte e shtruar me beton.

Ne te gjitha rastet, thaset e te gjitha llojeve te plehrave duhet te vendosen mbi paleta prej druri.

Ngurtesimi dhe lengezimi i plehrave kimike te te gjitha llojeve ndodh edhe ne rastet kur ato vendosen ne stiva mbi 7-8 rradhe (thase).

Ne keto raste, ne saj te presionit te ushtruar nga pesha, ndodh ngurtesimi dhe lengezimi i tyre. Per kete arsye, plehrat kimike, dhe vecanerisht ato azotike, nuk duhet te vendosen ne lartesi jo me shume se 7-8 thase.

Ne magazinat e ruajtjes se plehrave kimike, ne asnje rast, nuk duhet te mbahen produkte ushqimore si: bersi te ndryshme per ushqimin e blegtorise, farera te bimeve perimore apo pesticide. Ne rastet kur subjekti prodhues, shperdares dhe tregtues ben riamballazhim, ne keto raste ambalazhimi i plehrave kimike duhet te behet ne thase te rregullt plastike ose me dy shtresa ne menyre qe te mos depertoje lageshtia (reshjet apo lageshtia ajrore).

Transportimi i plehrave kimike, ne te gjitha rastet, duhet te behet i mbuluar me mushama me qellim qe te mbrohet nga reshjet dhe rrjedhjet qe mund te ndodhin gjate transportit.



Sherbimi i Kontrollit te Plehrave

Shefi i Sektorit Tokes

Abdulla Mani

Suzana Rrushi

Skender Belalla



Shefi i Departamentit te Tokes dhe Ujerave

Kol Cara

